

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8313  
E enjte, 4 qershor 2026  
Çmimi 0.50 €

Miratohet nisja e negociatave për heqjen e roaming-ut mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## COSTA NË KOSOVË: RRUGA DREJT BE-SË DHE NEVOJA PËR INSTITUCIONE STABILE, TEMA KRYESORE E DISKUTIMIT



FAQE 4-5

Presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, ka ardhur për vizitë të mërkurën Kosovën. Ai

është takuar me liderë të institucioneve dhe me ata të opozitës. Temë diskutimi ishte rruga e

Kosovës drejt BE-së dhe nevoja për institucione të qëndrueshme dhe të afta që të zbatojnë reforma



**RAMA PARALAJMËRON TARIFA PËR AUTOMJETET NGA 1 DERI NË 10 EURO PËR HYRJE NË PRISHTINË** F. 7

**BURGIMI I PËRJETSHËM: A PO E NDAL KRIMIN?** F. 4-5



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

### SPORT



**'DARDANËT' VAZHDOJNË PËRGATITJET PËR ANDORRËN** F. 11

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### OPINION

QEVERI E SHTIMES!

F. 6

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



### AKTUALE



**KOMITETI PËR POLITIKË TË JASHTME I PE-SË: KRIZA POLITIKE NË KOSOVË MUND TË REZULTOJË ME HUMBJE FINANCIARE** F. 2

**RAMA: SPAK-U VERIFIKOI PRONËSINË E INVESTITORËVE TË HUAJ MBI TOKËN NË ZVËRNEC** F. 2

### EKONOMI



**HAPET PANAIRI "AGROKOS" & "EXPOKOS" 2026, THIRRJE PËR RRRITJEN E PRODHIMIT VENDOR DHE ULJEN E DEFICITIT TREGTAR** F. 8

**GUVERNATORI ISMAILI TAKON ANËTARIN E BORDIT EKZEKUTIV TË FMN-SË: SEKTORI FINANCIAR NË KOSOVË MBETET I QËNDRUESHËM** F. 8

## KOMITETI PËR POLITIKË TË JASHTME I PE-së: KRIZA POLITIKE NË KOSOVË MUND TË REZULTOJË ME HUMBJE FINANCIARE

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Komiteti për Politikë të Jashtme i Parlamentit Evropian (AFET) ka miratuar raportin vjetor për Kosovën, në të cilin përsëritet se viti 2025 ishte vit i humbur për vendin, ndërsa tërhiqet vërejtja se edhe muajt e vitit 2026 po rrezikohen për shkak të krizës politike. Këto humbje, sipas dokumentit, do të rezultojnë edhe me humbje të mjeteve financiare nga Plani i Rritjes i BE-së, pasi ekziston frika se Kosova nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë kriteret e nevojshme. Pakoja e BE-së për Ballkanin Perëndimor - për periudhën 2024-2027 - është në vlerë të 6 miliardë eurove. Nga kjo shumë, Kosovës i takojnë rreth 882 milionë euro - 253 milionë si grante dhe 629 milionë euro në formë të kreditës - që do të thotë se vendi përfiton më së shumti fonde në rajon për kokë banori. Fundi i qershorit të këtij viti është momenti kur secili shtet i rajonit hyn në të ashtuquajturin moment të humbjes së përhershme nëse nuk i përmbush reformat. Burimet në Bruksel i kanë thënë më herët Radios Evropa e Lirë se nëse nuk ndërmerren të gjitha reformat, Kosova mund të humbasë 68.8 milionë euro. Gjatë krizës politike vitin e kaluar në Kosovë - kur u mbajtën dy palë zgjedhje parlamentare për shkak të pamundësisë së formimit të institucioneve - u vunë në dyshim fondet nga Plani i Rritjes, por edhe fonde nga mekanizma të tjerë

ndërkombëtarë. Vendi do të mbajë zgjedhje të reja parlamentare më 7 qershor të këtij viti, pasi legjislatura paraprake nuk arriti të zgjidhte një president të ri, duke bërë që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Autori i dokumentit, eurodeputeti, njeherësh raportuesi për Kosovën në PE, Riho Terras, ka vlerësuar se 18 muajt e fundit kanë qenë të vështirë për Kosovën. "Ngërçi politik ka një ndikim të rëndësishëm në të ardhmen e vendit. Është e rëndësishme që Kosova të qëndrojë në rrugën evropiane dhe të ecë përpara me integrimin", ka deklaruar Terras pas miratimit të dokumentit. Ai ka theksuar se raporti i miratuar ofron një vlerësim objektiv dhe të drejtë të situatës në Kosovë. "Ne theksojmë çështjet që lidhen me lirinë e medias, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu theksojmë zhvillimet pozitive - miratimin e vendimeve të nevojshme për Planin e Rritjes nga Kuvendi i Kosovës dhe, natyrisht, heqjen e masave të Komisionit Evropian ndaj Kosovës, të cilat janë lajme shumë të mira", ka shtuar eurodeputeti Terras. Në të ashtuquajturën deklaratë shpjeguese, të cilën Terras ia ka bashkëngjitur dokumentit zyrtar në formë aneksi, raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian vlerëson se zgjedhjet e vitit 2025, si ato parlamentare ashtu edhe ato lokale, janë

zhvilluar në mënyrë të rregullt. "Megjithatë, procesi normal politik është cenuar thellësisht", ka vlerësuar Terras. Ai, para votimit të raportit, tha se shpreson Kosova pas këtyre zgjedhjeve do të dalë nga qorrsoakaku politik. Përmes këtij dokumenti shprehet mbështetje e fuqishme për synimet e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, shprehet keqardhje për ngërçin politik dhe, siç u tha, polarizimin që po e shoqërojnë vendin si dhe për proceset e shumta zgjedhore të viteve të fundit. Në raport mbështetet, mes të tjerash, aplikimi i Kosovës për statusin e vendit kandidat dhe u bëhet thirrje shteteve anëtare që, pa vonesa të panevojshme, ta mandatojnë Komisionin Evropian për përpilimin e pyetësorit. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE në fund të dhjetorit të vitit 2022, por aplikimi i saj ende nuk është shqyrtuar nga BE-ja. Këshilli i Bashkimit Evropian, sipas raportit, ftohet të veprojë me shpejtësi dhe t'i japë Kosovës statusin e kandidatit pasi të jenë përmbushur kriteret përkatëse. Po ashtu, u bëhet thirrje pesë shteteve mosnjohëse të Bashkimit Evropian - Rumanisë, Greqisë, Sllovakisë, Spanjës dhe Qipros - që ta njohin pavarësinë e Kosovës, në mënyrë që të mundësohet avancimi i barabartë i Kosovës me shtetet



e tjera kandidate. Përhëndetet vendimi, siç thuhet, "ndonëse i vonuar", për heqjen e masave dhe theksohet se ato kanë qenë në kundërshtim të qartë me angazhimin e dëshmuar të Kosovës ndaj vlerave evropiane dhe përafrimit me politikat e Bashkimit Evropian. Vlerësohet se masat kanë qenë të pajustificuara dhe se ato kanë pasur ndikim negativ në shoqërinë e Kosovës. Në raport vihet në pikëpyetje mungesa e transparencës dhe e parashikueshmërisë, niveli i informimit publik, si dhe kohëzgjatja e zgatur e masave pavarësisht faktit se Kosova i kishte përmbushur kërkesat për heqjen e tyre. Ndërkaq përhëndetet përkushtimi i vazhdueshëm i Kosovës ndaj procesit integruar. Në këtë kontekst rikujtohet se dialogu për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, mbetet pjesë integrale e perspektivës

evropiane të Kosovës. Kosovës dhe Serbisë u bëhet thirrje të bashkëpunojnë dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për t'i sjellë sa më shpejt para drejtësisë autorët e sulmit të vitit 2023 në Banjskë. Një grup i serbëve të armatosur vranë një polic të Kosovës gjatë sulmit në Banjskë. Gjatë këmbimit të zjarrit që pasoi, u vranë edhe tre trumues serbë. Kosova fajëson Serbinë për sulmin, por Beogradi mohon përfshirjen. Për sulmin në Banjskë, autoritetet në Kosovë kanë dënuar tre të akuzuar, teksa dhjetëra të tjerë gjenden në arrati. Millan Radoičiq, ish-nënkryetari i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit - ka marrë përgjegjësinë për organizimin e sulmit, teksa Kosova kërkon vazhdimisht që Serbia ta ekstradojë atë. Në dokumentin e PE-së shprehet keqardhje për faktin se Serbia ende nuk i ka ndjekur penalisht përgjegjësit për këtë sulm, veçanërisht Radoičiqin. Dokumenti i miratuar në Komitetin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian do të paraqitet gjatë verës në njërin nga seancat plenare të Parlamentit Evropian, ku sërish do të hidhet në votim. Me atë rast, dokumenti do ta marrë formën e Rezolutës së Parlamentit Evropian.

## RAMA: SPAK-U VERIFIKOI PRONËSINË E INVESTITORËVE TË HUAJ MBI TOKËN NË ZVËRNEC

TIRANË, 3 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se pas verifikimeve të kryera nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), investitorët e huaj rezultojnë pronarë të një toke ku është planifikuar të ndërtohet një projekt turistik në Zvërnec, pranë Vlorës. Sipas të dhënave zyrtare, pronare e zonës së rrethuar me gardh metalik në Zvërnec rezultoi të jetë kompania Albania Land Development, e regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në Shqipëri më 27 maj 2025. Të dhënat e Qendrës Kombëtare të Biznesit tregojnë se pronarë të kësaj kompanie janë vëllezërit nga Katari, Mohamadmoataz Mhd Ruslan Alkhayat dhe Ramez Mhd Ruslan Alkhayat. "Një zhvillim që unë e konsideroj shumë pozitiv lidhur me procesin e verifikimit të transaksionit për

blerjen e tokës në Zvërnec, që do të thotë me sqarimin e plotë dhe përfundimtar të origjinës së fondeve të kaluara përmes bankës dhe me çlirimin përfundimtar të investitorëve që tanimë janë dhe pronarë", tha Rama pas mbledhjes së qeverisë shqiptare më 3 qershor. Ai vlerësoi edhe faktin që SPAK-u ka vendosur t'i mbajë të ngrira fondet pa i lënë të kalojnë te shitësi, për të cilin ka një proces hetimor. "Kjo, në këndvështrimin tim, është shumë pozitive edhe për këdo që pretendon pronë në atë territor, pasi çështja do të mbulohet nga një hetim tërësisht i pavarur nga SPAK-u, dhe në të dyja rastet rezultati do të jetë i padiskutueshëm nga pikëpamja ligjore dhe do t'i japë fund çdo pretendimi që nuk është i bazuar në ligj", tha Rama. Në lidhje me hetimet për



çështjen e pronësisë ndaj tokës në Zvërnec, zyra për medie e SPAK-ut sërish të mërkurën tha se "çështja ndodhet në një fazë procedurale, detajet e saj nuk mund të bëhen publike në këtë moment". Kreu i qeverisë shqiptare, Edi Rama, tha se hetimi do të tregojë nëse shitësi ka një origjinë legjitime të pronës dhe më pas do t'i marrë paratë.

Nëse do të rezultojë e kundërta, "paratë do t'i mbeten Republikës së Shqipërisë dhe patjetër që ato do të përdoren për cilindo që do të provojë se pretendimin mbi pronën e ka të bazuar". Banorë të fshatit Zvërnec kanë thënë për Radion Evropa e Lirë se janë të përfshirë në një kontest gjyqësor me një biznesmen nga Vlora, lidhur me

pronësinë e tokës në Zvërnec, për të cilën pretendojnë se u është marrë padrejtësisht. Ndërkaq, në lidhje me thirrjet e protestuesve për dorëheqjen e tij, Rama tha se nuk sheh arsye për dorëheqje dhe i cilësoi si përsëritje të debateve të vjetra politike. Ai tha se debati publik mbi mjedisin përdoret si instrument për t'i kundërshtuar projektet ekonomike, ndërsa theksoi se Shqipëria ka nevojë për zhvillim të turizmit elitare për ta rritur ekonominë. Ditë e fundit ka pasur protesta kundër punimeve në zonën e mbrojtur Pishë Poro-Nartë, ku është paraparë të ndërtohet një resor, mes shqetësimeve për ndikimin në mjedis dhe mosmarrëveshjeve mbi pronësinë e tokës. Kjo zonë është mjedis i mbrojtur dhe konsiderohet një nga habitatet më të rëndësishme në Shqipëri për zogjtë e ujit dhe ata shtegtarë, përfshirë flamingot.

# COSTA NË KOSOVË: RRUGA DREJT BE-së DHE NEVOJA PËR INSTITUCIONE STABILE, TEMA KRYESORE E DISKUTIMIT

Presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, ka ardhur për vizitë të mërkurën Kosovën. Ai është takuar me liderë të institucioneve dhe me ata të opozitës. Temë diskutimi ishte rruga e Kosovës drejt BE-së dhe nevoja për institucione të qëndrueshme dhe të afta që të zbatojnë reforma

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 3 QERSHOR** - Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se rruga e vendit drejt Bashkimit Evropian është interes strategjik shtetëror. Këto deklarata ajo i bëri gjatë takimit në Prishtinë me presidentin e Këshillit Evropian, Antonio Costa, me të cilin tha se bisedoi për një sërë çështjesh, përfshirë Planin e Rritjes të BE-së për Ballkanin Perëndimor si dhe stabilitetin rajonal. "Rruga e Kosovës drejt Bashkimit Evropian është interes strategjik shtetëror dhe zgjedhje demokratike e qytetarëve tanë", shkroi Haxhiu në "Facebook". Para nisjes së takimeve, Costa shkroi në X se i inkurajon udhëheqësit politikë në Kosovë që ta bëjnë prioritet integrimin në BE "dhe të punojnë së bashku drejt këtij qëllimi të përbashkët". "Kosova ka nevojë për institucione të forta, stabile dhe të afta që të zbatojnë reforma, që përfitojnë nga ajo që ofron BE-ja dhe t'i zbatojnë zotimet që dalin nga dialogu Kosovë - Serbi", shkroi Costa. Ndërkaq sipas njoftimit të lëshuar nga Presidenca, Haxhiu ka kërkuar që të avancohet procesi i integritimit, teksa Kosova është vendi i vetëm në rajon që nuk ka as statusin e vendit kandidat. Kosova ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022. Megjithatë, ky

aplikim ende nuk ka kaluar as në fazën e parë formale, atë të shqyrtimit nga Këshilli i BE-së dhe më pas dërgimit për opinion në Komisionin Evropian. Haxhiu vlerësoi se Kosova ka shoqërinë më "proevropiane në rajon", duke argumentuar se ky orientim është bazë për rrugën e shtetit drejt BE-së. Ndërkaq sa i përket Planit të Rritjes, Haxhiu tha se Kosova atë e shih si mundësi konkrete për zhvillim, "për afrim me tregun e përbashkët evropian dhe për përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët". Paketa financiare e BE-së për Ballkanin Perëndimor - për periudhën 2024-2027 - është në vlerë të 6 miliardë eurove. Fondet u ndahen vendeve të rajonit pjesërisht në formë grantesh dhe pjesërisht përmes kredive të favorshme. Gjatë qëndrimit në Prishtinë, Costa është takuar edhe me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. Kryeministri e falënderoi presidentin Costa për kontributin e Bashkimit Evropian si donatori më i madh në zhvillimin dhe ndërtimin e Kosovës, mbështetje të cilën Kosova e ka kthyer në kultivimin dhe promovimin e vlerave të BE-së si dhe në forcimin e institucioneve. Kurti theksoi se Kosova ka shënuar përparim të rëndësishëm në reforma, demokraci dhe ekonomi, me përmirësime në sundimin e

ligjit, luftën kundër korrupsionit, lirinë e medieve dhe demokracinë zgjedhore e liberale, si dhe me rritje ekonomike të qëndrueshme, ndër më të shpejtat në rajon. Ai vlerësoi se Bashkimi Evropian mbetet partneri kryesor zhvillimor i Kosovës. Kryeministri në detyrë Kurti theksoi përkushtimin e qeverisë ndaj reformave që derivojnë nga Plani i Rritjes dhe instrumentet e tjera të par-anëtarësimit, duke nënvizuar rëndësinë e marrjes së statusit kandidat. Në takim u bisedua edhe për bashkëpunimin me institucionet e Bashkimit Evropian, sigurinë dhe rëndësinë e fqinjësisë së mirë në funksion të bashkëpunimit rajonal. Kosova është rreshtuar plotësisht me politikën e jashtme të BE-së, ka dënuar luftën agresive të Federatës Ruse ndaj Ukrainës në termat më të ashpër dhe u është bashkuar të gjitha sanksioneve të BE-së kundër Rusisë. Kjo ishte vizita e dytë e presidentit Costa në Prishtinë, pas asaj që realizoi në maj të vitit të kaluar. Me përparimin e shënuar në vitet e fundit, me forcimin e sundimit të ligjit, avancimin e lirisë, forcimin e institucioneve demokratike dhe zhvillimin ekonomik, Kosova është e gatshme për statusin kandidat dhe hapjen e negociatave. Vizita e zyrtarit evropian në

Kosovë është në kuadër të një turneu në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. "Turneu im i dytë në Ballkanin Perëndimor dërgon një sinjal të qartë: zotimi i Bashkimit Evropian për rajonin është i vërtetë, sikurse është e vërtetë edhe mundësia për zgjerim. Momentumi ekziston. Tani është koha që të japim rezultate", tha ai përmes një njoftimi para nisjes së vizitave në rajon. Costa nisi turneun ballkanik në Sarajevë, ku u takua me anëtarët e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës dhe udhëheqësen e Këshillit të Ministrave. Një ditë më vonë ai qëndroi në Tiranë ku u takua me kryeministrin shqiptar Edi Rama dhe presidentin Bajram Begaj. Më pas, në Shkup zhvilloi takim me kryeministrin maqedonas Hristijan Mickoski. Pas qëndrimit në Prishtinë, Costa do të udhëtojë drejt Serbisë, për takime me presidentin serb Aleksandar Vučić, kryetaren e Parlamentit Ana Bernabiq dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Vizitat në rajon Costa do t'i përmbyllë në Mal të Zi, ku përveç takimeve me zyrtarët malazezë, ai do të jetë bashkudhëheqës i samitit BE - Ballkanin Perëndimor në Tivat. Tema e samitit të sivjetshëm, sipas BE-së, është "Prosperiteti i përbashkët dhe stabiliteti i BE-së dhe Ballkanit Perëndimor".

Vitin e kaluar ky samit u mbajt në Bruksel dhe Kosova u përfaqësua me tashmë ish-presidenten Vjosa Osmani, ndërkaq Serbia nuk mori pjesë. Në deklaratën e samitit të vitit të kaluar u tha se "mungesa e normalizimit të raporteve mes Prishtinës dhe Beogradit po mban të dy shtetet të bllokuara në rrugën evropiane". Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat, nën ndërmjetësimin e Brukselit, mbi një dekadë më parë. Gjatë procesit janë arritur një sërë marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar në terren. Dy vendet nuk kanë zhvilluar takim të nivelit të lartë politik që nga shtatori i vitit 2023, disa ditë para sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit. Një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës duke vrarë një rreshter. Gjatë këmbimit të zjarrit që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë. Kosova fajëson Serbinë për sulmin, por Beogradi mohon përfshirjen. Për sulmin në Banjskë autoritetet në Kosovë kanë dënuar tre të akuzuar, teksa dhjetëra të tjerë gjenden në arrati. Millan Radoiqiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit - ka marrë përgjegjësinë për organizimin e sulmit, teksa Kosova kërkon vazhdimisht që Serbia ta ekstradojë atë.



## BURGIMI I PËRJETSHËM: A PO E NDAL KRIMIN?

**Burgimi i përjetshëm ndëshkon rëndë, por nuk e rikthen humbjen dhe as nuk garanton drejtësi të plotë për viktimat. Edhe pse shqiptimet e dënimeve me burgim të përjetshëm në Kosovë janë shtuar, krimet e rënda vazhdojnë, duke ngritur dyshime mbi efektin real frenues**

**PRISHTINË, 3 QERSHOR** - "Asnjë vendim gjyqësor në botë nuk e kthen në jetë Liridonën"... Kjo fjali e thënë nga vëllai i saj, Leonard Ademaj, e vendos kufirin e drejtësisë: ajo mund të ndëshkojë, por nuk mund të rikthejë jetën. Megjithatë, në një vend ku dhimbja për kohë të gjatë mbetet pa përgjigje, vendimi për burgim të përjetshëm për vrasësit e Liridona Ademajt shihet si një hap - i vogël, por i rëndësishëm - drejt një lloj drejtësie.

Mbrëmjen e 29 nëntorit 2023, në një rrugë të fshatit Bërnice në Prishtinë, Liridona Ademaj u vra në praninë e dy fëmijëve të saj. Rasti tronditi opinionin publik dhe u shndërrua në një simbol të dhunës ekstreme dhe të kërkesës për drejtësi.

Më 21 prill 2026 Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli fajtorë tre persona për këtë vrasje: bashkëshortin e saj, Naim Murseli, si dhe Granit Plavën e Kushtrim Kokallën. Dy të parët u dënuan me burgim të përjetshëm, ndërsa i treti me 30 vjet burgim. "Sadopak ka

lehtësuar dhimbjen e familjes", thotë Ademaj për Radion Evropë e Lirë.

Por, ai e di se procesi nuk përfundon këtu. Mbrojtja ka paralajmëruar ankesë dhe rasti pritet të kalojë në Gjykatën e Apelit dhe në Supreme. "Shpresojmë që edhe instancat më të larta ta konfirmojnë këtë vendim. Vetëm dënime të tilla mund t'i ndalin vrasjet e nënave dhe motrave tona", thotë Ademaj.

### Dënim i rëndë, por jo gjithmonë përfundimtar

Burgimi i përjetshëm është dënimi më i rëndë në sistemin penal të Kosovës.

Që nga hyrja në fuqi e Kodit Penal në vitin 2013 ai është shqiptuar në 13 raste.

Sipas të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), të siguruar nga Radio Evropa e Lirë, në shumicën - 12 prej tyre - bëhet fjalë për vrasje të rënda, ndërsa vetëm një rast lidhet me terrorizëm.

Ligji e parasheh këtë dënim për

36 vepra penale të kryera në rrethana rënduese, përfshirë gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe tradhtinë ndaj shtetit.

Megjithatë, praktika tregon se rruga deri te një vendim përfundimtar është e gjatë dhe e pasigurt.

Dënimi i parë me burgim të përjetshëm, i shqiptuar në vitin 2015 për vrasje të rëndë, u zbut më pas nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme në 25, respektivisht 22 vjet burgim.

Sipas Flamur Kabashit nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), përdorimi i këtij dënimi është shtuar në vitet e fundit. "Sipas monitorimeve tona, kohët e fundit kemi parë shtim të shqiptimeve me burgim të përjetshëm. Por, vendimet marrin formë të prerë vetëm kur konfirmohen nga shkalla e dytë", thotë Kabashi për Radion Evropë e Lirë.

Në disa raste, më shumë se një person dënohet me burgim të përjetshëm në të njëjtin proces. Vetëm përgjatë vitit të kaluar u shqiptuan tri dënime të tilla.

Në maj të vitit 2025 Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi me burgim të përjetshëm vëllezërit Jeton dhe Nexhat Vllasaliu, të akuzuar për vrasjen e biznesmenit Bedri Rexhepi.

Vendimi u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit në prill të këtij viti.

Po këtë prill, Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi me burgim të përjetshëm Naim Murselin dhe Granit Plavën për vrasjen e Liridona Ademajt.

Në fund të prillit, Gjykata Themelore dënoi me burgim të përjetshëm edhe Bllagoje Spasojeviqin dhe Dushan Maksimoviqin për kryerje të veprës terroriste, të ndërlidhur me cenimin e rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës.

### Drejtësia nën presion dhe në dilemë

Me gjithë këto zhvillime, ish-kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Hasani, vlerëson se burgimi i përjetshëm rrallëherë ka marrë formë përfundimtare.

"Sot për sot, vetëm një rast mund të konsiderohet i prerë - rasti i Dardan Krivaqës", thotë ai, duke shtuar se edhe ky rast mbetet juridikisht i hapur për sfidim.

Dardan Krivaqa është shpallur fajtor për vrasjen e Marigona Osmanit në vitin 2021, në të tria shkallët e sistemit gjyqësor.

Gjykata Supreme e ka konfirmuar vendimin, megjithatë, sipas praktikës procedurale, rasti ende mund të jetë objekt i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Këtë e konfirmon për Radion Evropë e Lirë edhe avokati mbrojtës i Krivaqës, Skender

Musa, i cili thotë se po përgatitet një kërkesë e tillë. "Jemi duke e përgatitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila lidhet kryesisht me dënimin me burgim të përjetshëm, të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë dhe të konfirmuar nga gjykata e shkallës së dytë dhe ajo Supreme", shpjegon Musa.

Ai thotë se gjatë procesit janë shkelur procedurat në ekspertizën ligjore dhe shton se, nëse Gjykata Supreme nuk e kthen rastin në rigjykim, mbrojtja do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Kabashi nga IKD-ja sqaron se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë përbën një instancë të jashtëzakonshme e cila mund të ndikojë në ndryshimin e vendimit përfundimtar nëse konstatohet shkelje ligjore. "Të njëjtën instancë gjyqësore mund ta shfrytëzojnë edhe vëllezërit Vllasaliu", thotë ai.

Në disa raste të tjera, dënimet me burgim të përjetshëm janë zbutur nga Gjykata e Apelit ose Gjykata Supreme, duke u zëvendësuar me dënime deri në 35 vjet burgim.

Nga 13 raste të regjistruara me burgim të përjetshëm, vetëm një ka përfunduar me lirimin e të akuzuarit.

Në prill të vitit 2023 Gjykata Supreme e shpalli të pafajshëm Naser Pajazitin, i cili fillimisht

# MIRATOHET NISJA E NEGOCIATAVE PËR HEQJEN E ROAMING-UT MES BE-së DHE BALLKANIT PERËNDIMOR



**PRISHTINË, 3 QERSHOR** - Ambasadorët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) kanë miratuar fillimin e negociatave për heqjen e roaming-ut me shtetet e Ballkanit Perëndimor, është konfirmuar zyrtarisht nga Këshilli i BE-së. Vendimi ka të bëjë me hapjen e negociatave me Kosovën, Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë për roaming-un në rrjetet publike të komunikimeve mobile.

Këshilli i BE-së pritet që të enjten, më 4 qershor, ta miratojë zyrtarisht vendimin, më pas mund t'i nisin negociatat me secilin shtet të rajonit në mënyrë individuale. Nga Presidenca qipriote e Bashkimit Evropian u tha se mbështesin fuqishëm rrugën evropiane të Ballkanit Perëndimor. "Zgjerimi i zonës pa roaming është një shenjë e qartë e përkushtimit tonë ndaj rajonit. Mirëpresim miratimin formal të vendimit me të cilin autorizohet hapja e negociatave për marrëveshjet",

deklaroj një zëdhënës i Presidencës që udhëhiqet nga Qiproja. Komisioni Evropian në muajin shkurt kishte propozuar heqjen e roaming-ut për Ballkanin Perëndimor. "Roam Like at Home" (Pa tarifa shtesë) zbatohet në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e Zonës Ekonomike Evropiane. Në janar të këtij viti, rregullorja është zgjeruar edhe për Ukrainën dhe Moldavinë, edhe pse këto vende nuk janë anëtare të BE-së. Zyrtarët evropianë presin që

negociatat të përfundojnë deri në fund të këtij viti. Në një skenar ideal, roaming-u midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së mund të hiqet që vitin e ardhshëm. Megjithatë, zyrtarët evropianë theksojnë se gjithçka varet nga gatishmëria e vendeve të rajonit për të përparuar në këto negociata. "Roam Like at Home" përfaqëson një nga politikatat më të suksesshme të Bashkimit Evropian të dedikuara qytetarëve të tij. Ai është në fuqi që nga viti 2017. Bëhet fjalë për një rregullore

të Komisionit Evropian që mundëson përdorimin e telefonave celularë në shtetet e tjera anëtare me të njëjtat çmime si në vendin e origjinës. Kjo do të thotë se gjatë përdorimit të telefonit celular në zonën e BE-së nuk ka kosto shtesë për thirrje, SMS dhe përdorimin e internetit, por aplikohen tarifat e vendit të origjinës. I njëjti rregull vlen edhe për thirrjet dhe mesazhet që përdoruesit i marrin gjatë qëndrimit jashtë vendit.

ishte dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e Donjeta Pajazitit në vitin 2015.

## A e ndal krimin burgimi i përjetshëm?

Në teori, çdo dënim penal synon parandalimin - si të individit, ashtu edhe të shoqërisë në tërësi. Por, në praktikë, efektiviteti i burgimit të përjetshëm mbetet i diskutueshëm. Të dhënat e Policisë së Kosovës, të siguruar nga Radio Evropa e Lirë, tregojnë se nga viti 2013 deri në vitin 2025 janë regjistruar 411 vrasje të të gjitha llojeve. Nëse përfshihen edhe vitet para hyrjes në fuqi të këtij dënimi, numri total i vrasjeve në 25 vjet arrin në 1 558. Vetëm brenda një dite të javës së kaluar u raportuan dy vrasje - një në Prishtinë, një në Mitrovicë të Jugut. Për ekspertët këto shifra nuk tregojnë ndonjë efekt të qartë parandalues. "Fakti që në pesë vjetet e fundit janë shtuar dënimet e tilla, nuk dëshmon domosdoshmërisht

efekt parandalues. Kryerësit e veprave vazhdojnë të kryejnë krime të rënda", thotë Kabashi. Edhe Hasani ndan të njëjtin qëndrim: "Nuk kam vërejtur ndonjë efekt konkret nga ky dënim në praktikë".

## Ndikimi i opinionit publik

Në sallat e gjyqit vendimet duhet të varen vetëm nga provat dhe ligji. Por, jashtë tyre, një tjetër zë shpesh bëhet i pamohueshëm: opinionin publik. Ish-Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, thotë se rastet që marrin vëmendje të madhe mediatike dhe publike shpesh krijojnë një lloj presioni të heshtur edhe mbi sistemin e drejtësisë. "Kemi përshtypjen se sa herë që raste të tilla dominojnë në opinionin publik, kjo reflektohet edhe në qasjen e sistemit gjyqësor. Vërehet një kujdes i shtuar dhe një vëmendje e posaçme për rastet që kanë zgjuar interes publik. Kështu nuk do të duhej të ishte", thotë Jashari, duke theksuar se gjykatat duhet të

veprojnë të pavarura dhe të paanshme. Në të njëjtën linjë, ish-kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Hasani, pranon se ndikimi i opinionit publik dhe medieve nuk është gjithmonë i shmangshëm. "Jam i bindur që në disa raste ka pasur ndikim të medieve dhe opinionit publik", thotë ai, por shton se kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht padrejtësi në vendimarrje. Për avokatin Musa, ky presion ndihet më së shumti në anën e mbrojtjes. Ai thotë se proceset për vepra të rënda penale, sidomos ato që mund të përfundojnë me burgim të përjetshëm, zhvillohen në një atmosferë të rënduar jo vetëm juridike, por edhe shoqërore. "Në radhë të parë, avokati duhet të luftojë me vetveten. Duhet të shmangë çdo element subjektiv dhe të fokusohet vetëm në prova, dispozita ligjore dhe doktrinën juridike. Është jashtëzakonisht sfiduese", thekson ai. Përveç presionit publik, këto procese karakterizohen edhe nga kohëzgjatja e tyre. Sipas Musës, rastet dallojnë për nga

kompleksiteti, por mesatarisht një proces për vrasje që mund të përfundojë me burgim të përjetshëm zgjat nga 12 deri në 36 muaj. Ndërsa përfundimi i të gjitha procedurave, përfshirë ankesat dhe rigjykimet e mundshme, mund të zgjasë deri në pesë vjet.

## Një sistem që kërkon më shumë se ndëshkim

Përtej debatit mbi dënimin, problemi duket të jetë më i thellë. Sipas Jasharit, mungesa e harmonizimit të politikave ndëshkuese krijon pabarazi dhe cenon sigurinë juridike. Në praktikë, gjykata të ndryshme mund të shqiptojnë dënime të ndryshme për vepra të ngjashme, duke minuar besimin e qytetarëve në drejtësi. "Në një shtet normal këto situata nuk guxojnë të ndodhin, sepse kërcënojnë një prej parimeve themelore të sistemit të drejtësisë, që ka të bëjë me atë që njihet si siguri juridike", thotë Jashari. Hasani, nga ana tjetër, thekson

se lufta kundër kriminalitetit nuk mund të mbështetet vetëm në dënime të rënda. Faktorë të tjerë - socialë, ekonomikë dhe edukativë - luajnë një rol po aq të rëndësishëm në parandalimin e krimeve.

## Korniza ligjore

Kodi Penal i Kosovës parashikon që burgimi i përjetshëm nuk mund t'u shqiptohet personave nën moshën 21 vjeç në momentin e kryerjes së veprës. Po ashtu, personat e dënuar me këtë masë fitojnë të drejtën për kërkesë për lirim me kusht pas së paku 30 vjetësh burgim. Deri më sot asnjë i dënuar nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, kryesisht për arsye procedurale dhe kohore. Dhe, ndërsa sistemi vazhdon ta kërkojë balancën mes ndëshkimit dhe parandalimit, familja Ademaj mbetet me një realitet të pandryshueshëm. "Fëmijët e Liridonës nuk do ta shohin më nënën e tyre", thotë Leonard Ademaj.

# QEVERI E SHTIMES!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Vdekja e moralit e forcon marrëzinë:** Partitë politike e kanë intensifikuar fushatën duke lëvizur nga vendi në vend sikur dikur cirket lëvizëse. Partia në pushtet LV-ja bashkë me mbetjet mortore politike, "Guxo", "Aletnativa" dhe "PSHDK" po bëjnë propozime që as SHBA - atë nuk mund t'i realizojnë ku rrenën dhe mashtrimin i kanë vënë mbi themelet e "demokracisë", si vlera të shtuara. Nuk po lënë mjet pa përdorur para votuesve, thuaja analfabetë që e kanë mendësinë e një trushpëlari, jo se duan më shumë vota por se po ndjehen të rrezikuar nga një shembje elektorale. Më herët kam shkruar se do të jenë zgjedhje interesante dhe se, ose do të shembet diktatura e Kurthit, ose Kurthi do të shpallet Cezar, imperator. Cezari gjatë diktaturës i pati rrëmbyer të gjitha pozitave në perandorinë Romake sikur që po e bënë tani Albin Kurthi, diktatori i parafundit në Ballkan. I pari është Aleksandar Vučić. Po të përshkruaja të gjitha mashtrimet dhe paskrupullësitë që i përdorë Kurthi për ta mbajtur pushtetin më duhet aq hapësirë sa iu ka dashur intelektualit dhe ideologut të LV-

së, Agim Bahtiri që ka paralajmëruar disa libra për ta përshkruar dhe përjetësuar injorancën, analfabetizmin dhe sançonqizmin njerëzor, kombëtar, moral dhe politik. Se poshtërsia nuk ka fund në oqeanin e pamoralshëm për vota, Kurthi e dëshmoi në Vushtrri duke keqpërdorur për vota një fëmijë 10-vjeçar. Në fakt fëmijën e keqpërdorën babai dhe nëna duke e dorëzuar në duart e një keqbërësi dhe shpërdoruesi patologjik, Kurthit. Në një vend normal dhe me institucione normale Kurthi do të dënohej me para dhe votë kurse "prindërit abuzues" do të privoheshin nga e drejta ta rrisin dhe edukojnë atë fëmijë duke e dërguar në institucione normale të vendosjes dhe edukimit. Po Kosova përfundimisht nuk është vend normal dhe nuk ka as institucione normale ndryshe ata "prindër" do të përgjigjeshin për shtytje për urrejtje dhe thirrje për dhunë. E keqja nuk përfundon këtu por vazhdon me duartrokitje të Kurthit, shpuresë së gardhit që e përcjellë dhe pjesëmarrësve në sallë, pa asnjë dallim. Aq urrejtje kundër atyre që sakrifikuuan çdo gjë për këta që po e gëzojnë lirinë e pamerituar nuk e besoj se e kanë shpërfaqur as armiqet e Kosovës që kanë treguar një respekt për patriotët e vërtetë! Merreni me mend se ku po shkojmë si Komb dhe si shtet me kësi instrumentalizimi antinjerëzorë dhe antikombëtarë që po e promovon LV-ja dhe Albin Kurthi! Njohësit e sigurisë në nivel lokal, rajonal dhe global e kanë të qartë se keqpërdorimi i

fëmijëve për qëllime politike, ekonomike apo të pushtetit ka prodhuar situata me shumë viktima ku fëmijët janë shndërruar në vrasës, kriminelë dhe përbindësh të vërtetë. Kujtojini fëmijët e Hamasit në aksione vetëvrasëse, fëmijët afrikanë të armatosur me kallashnikov, fëmijët e narkokarteleve në Amerikën e Jugut! Nga dhuna verbale deri te dhuna fizike dhe krimi është një hapësirë e një fije peri. Të poshtë, skajshmërisht të poshtë. Vetëm anatominë e kanë në formë të njeriut, përmbajtjen e kanë puro kriminale të gjithë ata që keqpërdorin fëmijë pavarësisht përkatësisë etnike, gjinore, racore apo bindjeve politike.

**Pa asnjë përjashtim:** Faktorët që e bëjnë diferencën në këto zgjedhje: Janë tre faktorë për të cilët besoj se do të jenë përcaktues për rezultatin e zgjedhjeve të 7 qershorit 2026. 1. Numri i përgjithshëm i votuesve. 2. Numri i votuesve nga diaspora dhe 3. Për kënd do të votojnë të papërcaktuarit. LV-ja do të humbë vota nëse ulet përqindja e votuesve në përgjithësi dhe diasporës, në veçanti. LV-ja kryesisht po angazhohet për të fituar votat e të papërcaktuarve. Nëse PDK-ja arrin ta ruaj votën e votuesve të zgjedhjeve të dhjetorit (192.000) në rrethana të mosdjaljes në zgjedhje që dolën në dhjetor, do të ketë rritje automatike deri në, së paku 5-7 deputetë. LDK-ja pati rënie apokaliptike të votuesve në zgjedhje të dhjetorit

dhe është shumë e pritshme të sillet kah 20 përqindësi, diçka nga rikthimi dhe diçka si "pajë" e presidentes permanente apo renta kar presidentes. AAK-ja do të sillet midis 7 dhe 9 deputetëve. LV-ja maksimumin do të ketë 45 deputetë. Për të gjithë vlen marzha e gabimit 3-4 për qind. Mendoj se LV-ja e ka të sigurt vetëm kryetarin e Kuvendit, qeverinë nuk do të mund ta formojë pa koalicion dhe marrëveshje me një parti shqiptare. Më me rëndësi do të jenë koalicionet që detyrueshëm do të formohen, se rezultatet e zgjedhjeve. Kushdo që e formon qeverinë, do ta ketë mandatin e plotë. Besoj se opozita do të fitojë mjaftueshëm mandate për formim të qeverisë, nëse pajtohen për një koalicion. Në këtë kontekst opozita duhet ta votojë çdo kandidat të propozuar nga LV-ja për kryetar Kuvendi dhe president. Gjithashtu nuk konsideroj aspak mungesë patriotizmi e lëre më tradhti nëse cilido subjekt politik, LV, PDK, LDK apo AAK të bashkëpunojnë me Listën Serbe. Duhet të lirohemi nga kjo hipotekë e rreme!

**Emërtimi i rrugëve në Mitrovicë e Atiqit dhe Gime Gushafci:** "Shotë Galica" e sotme, me emrin artistik, Fitore Pacolli, 4 ditë para zgjedhjeve vendosi tabela me emërtime të reja në Mitrovicë të Veriut. U përmendën dy emërtime që zgjojnë interesim dhe

përjashtojnë njëra - tjetrën; e nacionalistit dhe shovinistit të madh serb me prejardhje malazeze, Zoran Xhinxhiqi dhe patriotit të madh shqiptar, Isa Boletini. Njeriu dhe politikani më i rrezikshëm i Serbisë për shqiptarët dhe Kosovën pas përfundimit të luftës ishte pikërisht Xhinxhiqi, sepse i bindi ndërkombëtarët se Kosova duhet të ndahet për të siguruar paqe në Ballkan. Prandaj u vra nga paramilitarët e Legias sepse ata e donin tërë Kosovën dhe jo vetëm një pjesë të saj. Isa Boletini, me shumë anëtarë të familjes dhe shokë u vra nga baba i komunistit malazez Milovan Gjilas, sepse e donte Kosovën të bashkuar me Shqipërinë dhe jo të ndarë. Realisht, kryetari me mandat të vjedhur në Mitrovicë, Faton Peci është dashur ta vendosë tabelën me emrin e Isa Boletinit sepse ai është, fakt Faton Boletini por se nga frika prej serbëve është shndërruar në pec dhe tash e ka emrin artistik, Faton Peci. Emërtimi i një rruge me emrin e Zoran Xhinxhiqit pikërisht para zgjedhjeve LV-ja po e përdorë për joshjen e serbëve të "moderuar" si Rashiqi dhe kundër serbëve "radikalë", si Lista Serbe. Po flitet se Mimoza Kusari i ka bërë një lutje personale KM kujdestar Albin Kurthi që gjatë vendosjes së tabelës së radhës për emërtim me emrin e zemlakut të saj, Milan Radoičiq, pikërisht ajo ta vendosë tabelën. Mimoza Kusari, me plotë të drejtë shpreson se nuk do të zhgënjehet nga Kurthi. Ta shohim.

## ZËVENDËSMINISTRI I MBROJTJES, GEGË LLESHI, MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE ASDA 2026 NË ZAGREB

Prishtinë, 3 qershor - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Gegë Lleshi, së bashku me delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes, po merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Mbrojtjes dhe Sigurisë ASDA 2026, e cila po mbahet në Zagreb, Kroaci, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, forcave të armatosura, industrisë së mbrojtjes dhe ekspertë të sigurisë nga vende të ndryshme të botës. Ceremonia e hapjes nisi me fjalimin e sekretarit Shtetëror të Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë, Tomislav Galić, i cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të përvojave në



adresimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë. Gjatë panelit të parë të konferencës diskutua mbi transformimin e industrisë së mbrojtjes përmes teknologjive të reja dhe inovacionit.

U vlerësua se inteligjenca artificiale, algoritmet e avancuara, sistemet autonome dhe dronët po ndryshojnë rrënjësisht konceptin e operacioneve moderne ushtarake duke krijuar mundësi

të reja për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse. Vëmendje e veçantë iu kushtua menaxhimit të spektrit elektromagnetik, integrimin të inteligjencës artificiale në sistemet e mbrojtjes si dhe nevojës për investime të vazhdueshme në kërkim dhe zhvillim. Sipas ekspertëve, zhvillimi i industrisë vendore të mbrojtjes mbetet faktor kyç për forcimin e sigurisë kombëtare dhe rritjen e qëndrueshmërisë strategjike të shteteve. Në diskutime u trajtua edhe ndërlidhja ndërmjet teknologjive të mbrojtjes dhe zhvillimit të sektorit hapësinor, ku u theksua se shumë inovacione teknologjike burojnë nga kërkimet në industrinë e

mbrojtjes dhe po kontribuojnë në avancimin e sistemeve satelitore dhe teknologjive hapësinore. Panelistët nënvizuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike, laboratorëve kërkimorë dhe forcave të armatosura, duke vlerësuar se inovacioni dhe zhvillimi teknologjik kërkojnë ndërveprim të vazhdueshëm ndërmjet kërkimit shkencor dhe testimit praktik në terren. Pjesëmarrja në këtë konferencë paraqet mundësi të rëndësishme për shkëmbim përvojash, forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe njohje me zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

## Nderohet kujtimi i heroit Skënder Rexhepi, komandant "Hekuri"

RAHOVEC, 3 QERSHOR - Në ditëlindjen e 61-të të heroit të kombit, Skënder Rexhepi - komandant "Hekuri", u vizitua shtëpia-muze e tij në fshatin

Mrasor, në shenjë nderimi dhe respekti për jetën, veprën dhe sakrificën e tij për lirinë e vendit. Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se me trimërinë,

përkushtimin dhe qëndrueshmërinë e tij deri në frymën e fundit, komandant "Hekuri" mbetet simbol i luftës çlirimtare dhe frymëzimi për brezat e

ardhshëm. "Lavdi e përjetshme heroit të kombit, Skënder Rexhepi - komandant 'Hekuri'", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



# RAMA PARALAJMËRON TARIFA PËR AUTOMJETET NGA 1 DERI NË 10 EURO PËR HYRJE NË PRISHTINË

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar pas debatit publik të ditëve të fundit rreth mundësisë së vendosjes së një tarife për automjetet që hyjnë në kryeqytet, duke theksuar se bëhet fjalë vetëm për një ide në diskutim dhe jo për një vendim të marrë. Sipas Ramës, është propozuar që automjetet që nuk janë të regjistruara në komunën e Prishtinës të paguajnë një tarifë prej 1 deri në 2 eurosh për hyrje në qytet, ndërsa kamionët e mëdhenj deri në 10 euro. Megjithatë, ai ka theksuar se vendimi përfundimtar do të varet nga debati publik dhe kontributi i qytetarëve.

Rama ka sqaruar se arsyeja e shqyrtimit të kësaj alternative lidhet me nevojën për financimin e projektit të Unazës së Kryeqytetit, një investim që, sipas tij, do t'i reduktonte kolonat, ndotjen dhe do ta përmirësonte qarkullimin në Prishtinë. Ai ka bërë me dije se paketa financiare për këtë projekt kap vlerën e rreth 206 milionë eurove, ku deri në 40 për qind e shumës janë grante

që nuk do të duhej të ktheheshin nga qytetarët. Sipas tij, këto fonde nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim vazhdojnë të mbeten të bllokuara. "Pra, nëse qeveria i zhblokoi fondet e BERZh-it për ndërtimin e Unazës së Qytetit nuk do të ketë tarifa për askënd", ka deklaruar Rama.

Kryetari i Prishtinës ka shtuar se tarifa e kongestionit po shqyrtohet vetëm si mekanizëm alternativ financiar dhe jo si qëllim për mbledhjen e të hyrave, duke ftuar qytetarët, ekspertët, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë me ide në këtë proces. "Prishtina nuk mund të presë pafundësisht", ka përfunduar ai.

## GAP-i dhe KLGJ kërkojnë nga komuna e Prishtinës tërheqjen e dispozitave diskriminuese

Ndërkaq Instituti GAP dhe Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) kërkojnë tërheqjen e dispozitave diskriminuese dhe konsultim publik të ndarë dhe të veçantë për Rregulloren e re të

kryeqytetit për taksa, tarifa dhe gjoba komunale. "Shprehim shqetësim lidhur me 'Draft Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale' të Komunës së Prishtinës, e cila është në fazën e konsultimit publik. Përmbajtja e disa dispozitave të këtij drafti rrezikon t'i shkelë parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe arsyeshmërisë në trajtimin e qytetarëve, subjekteve dhe kategorive të ndryshme. Drafti parashikon vendosjen e tarifave komunale për veprimtari ekonomike pa paraqitur një metodologji të qartë të llogaritjes apo një analizë të ndikimit ekonomik, si dhe propozon një taksë prej 10 eurosh për hyrjen në territorin e kryeqytetit vetëm për automjetet e regjistruara jashtë Prishtinës. Këto masa krijojnë trajtim të pabarabartë ndërmjet kategorive të ndryshme të qytetarëve dhe bizneseve dhe rrezikojnë ta cenojnë parimin e mosdiskriminimit", thuhet në reagimin e tyre.

Po ashtu, në reagim theksohet se është e rëndësishme të rikujtohet se komuna e Prishtinës është e vetmja komunë në Kosovë që përfiton

grant shtesë për shkak të statusit si kryeqytet, duke marrë nga buxheti shtetëror rreth 20 milionë euro në vit. "Kjo mbështetje financiare synon ta adresojë ngarkesën e shtuar administrative dhe funksionale të kryeqytetit, por edhe të krijojë kushte më të mira për zhvillim dhe mundësi të barabarta për të gjithë. Pikërisht për këtë arsye, politikat komunale, sidomos ato që ndikojnë drejtpërdrejt në bizneset, qytetarët dhe shërbimet duhet të udhëhiqen nga parimi i mosdiskriminimit dhe nga një qasje gjithëpërfshirëse, e cila nuk prodhon efekte përjashtuese e as nuk krijon barrë të pabarabartë për kategori të caktuara", është thënë në reagimin e GAP-it dhe KLGJ-së, duk i bërë thirrje komunës së Prishtinës që të heqë dorë nga dispozitat dhe praktikatat që prodhojnë trajtim diskriminues ose përjashtues, qoftë përmes kategorizimeve të paarsyetuara, qasjeve selektive ndaj subjekteve të caktuara, apo vendosjes së barrës fiskale pa kriter të qarta dhe vlerësim paraprak; Ta nënshtrojë Rregulloren e re një konsultimi publik të ndarë dhe të

strukturuar sipas grupeve/subjekteve të prekura, në mënyrë që procesi të jetë kuptimplotë, transparent dhe i drejtë. Një dokument me ndikim kaq të gjerë, që prek shumë sektorë ekonomikë dhe kategori të ndryshme, nuk mund të trajtohet me një konsultim të përgjithshëm formal, pa diskutim të drejtpërdrejtë me grupet e interesit; Të sigurojë arsyetim të qartë dhe analizë të ndikimit për ndryshimet e propozuara, përfshirë kriteret e përzgjedhjes së kategorive, nivelin e tarifave, si dhe efektet e mundshme në konkurrencë, punësim dhe klimë biznesi në kryeqytet. "Ne vlerësojmë se rregulloret komunale duhet të nxisin rregullsinë, përmirësimin e shërbimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke garantuar trajtim të barabartë për qytetarët dhe bizneset. Prandaj, komuna e Prishtinës duhet ta zhvillojë këtë proces përmes konsultimeve reale dhe rregullave të drejta, në frymën e qeverisjes së hapur që i shërbejnë kryeqytetit dhe qytetarëve", është thënë në reagimin e Institutit GAP dhe Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ).

## GUVERNATORI ISMAILI TAKON ANËTARIN E BORDIT EKZEKUTIV TË FMN-SË: SEKTORI FINANCIAR NË KOSOVË MBETET I QËNDRUESHËM

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, priti në takim Yigit Yaşar, drejtor ekzekutiv dhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në takim mori pjesë edhe Hajdar Korbi, këshilltar i Republikës së Kosovës në Drejtorinë Ekzekutive të Konstituencës së FMN-së ku bën pjesë Kosova. Gjatë takimit guvernatori Ismaili e informoi Yaşar për zhvillimet kryesore në sektorin financiar dhe prioritetet strategjike të BQK-së, me fokus në ruajtjen e stabilitetit financiar, forcimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, avancimin e kornizës rregullative dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet evropiane. Guvernatori Ismaili theksoi se sektori financiar në Kosovë mbetet mirë i kapitalizuar,

likuid dhe me performancë të qëndrueshme. Në këtë kontekst u diskutua rëndësia e zbatimit të Planit Strategjik 2024-2028 të BQK-së si kornizë orientuese për reformat institucionale, modernizimin e sistemeve të pagesave, digjitalizimin, mbrojtjen e konsumatorëve financiarë dhe zhvillimin e tregjeve financiare. Një pjesë e rëndësishme e diskutimit iu kushtua bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe FMN-së, përfshirë asistencën teknike dhe dialogun e vazhdueshëm në fusha kyçe si stabiliteti financiar, mbikëqyrja bankare, politika makroprudenciale, qeverisja institucionale dhe zhvillimi i kapaciteteve. Në përmbyllje, guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të FMN-së ndaj Republikës së Kosovës dhe



Bankës Qendrore, duke vlerësuar kontributin e saj në forcimin e stabilitetit financiar dhe avancimin e agjendës së reformave. Ai ritheksoi përkushtimin e BQK-së për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me FMN-në në

funkcion të stabilitetit financiar dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit financiar. Vizita e Yaşarit në Kosovë lidhet me pjesëmarrjen e tij në konferencën ndërkombëtare të nivelit të lartë që mbahet nga Banka Qendrore e Republikës së

Kosovës, e cila mbledh përfaqësues të lartë të bankave qendrore, institucioneve financiare dhe partnerëve ndërkombëtarë për të diskutuar zhvillimet aktuale dhe prioritetet strategjike të sektorit financiar.

## HAPET PANAIRI 'AGROKOS' & 'EXPOKOS' 2026, THIRRJE PËR RITJEN E PRODHIMIT VENDOR DHE ULJEN E DEFICITIT TREGTAR

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Është hapur panairi "Agrokos" & "Expokos" 2026, në të cilin u tha se duhet të bëhet përpjekje më e madhe për ta ulur deficitin tregtar dhe për ta rritur prodhimin vendor. Ministri në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, duke folur në këtë panair, tha se shteti i Kosovës duhet të fuqizohet dhe të rritet besimi në produktet "Made in Kosova". Ajo tha se me një sektor privat të fortë edhe Kosova është e fortë, duke shtuar se përmes resurseve që ka vendi duhet ta ngrehim edhe ekonominë aty ku e meriton. Bekim Xhafa nga "Agrokos", tha se ky është viti i 26 që kur organizohet ky panair dhe, sipas tij, ka shërbyer për të gjitha bizneset start-up për të hyrë në treg. Mirsad Jasarspahic, kryetar i



Odës Ekonomike e Bosnjë-Hercegovinës, ka treguar se më vendimin e qeverisë për t'ua larguar vizat këtyre të fundit është lehtësuar pjesëmarrja në panairin në Kosovë.

Edhe ministri i Punës, Andin Hoti, ka vizituar panairin "Agrokos & Turizëm 2026", një ngjarje që pasqyron potencialin, kreativitetin dhe frymën sipërmarrëse të prodhuesve

tanë vendorë. "Ishte kënaqësi të shoh nga afër produktet vendore, iniciativat e reja dhe energjinë krijuese që po e fuqizon sektorin agro dhe atë të turizmit. Mbështetja e

prodhimit vendor dhe promovimi i potencialit tonë ekonomik mbeten ndër prioritetet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Gjatë bashkëbisedimeve me pjesëmarrësit e panairit, theksova edhe rëndësinë e politikave aktive të punësimit, me fokus të veçantë te të rinjtë dhe gratë", ka theksuar Hoti. Ai ka thënë se në këtë drejtim programi Super Puna po vazhdon të mbështesë të rinjtë me subvencionim prej 500 eurosh në muaj për gjashtë muaj, duke u krijuar mundësi më të mira për punësim dhe fitim të përvojës profesionale. "Po ashtu, kemi paraqitur edhe Super Punën për Gratë, një masë e re që do të bëhet aktive në fillim të mandatit të ri, me synimin për ta rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe fuqizimin e tyre ekonomik", ka deklaruar Hoti.

## AKB-ja vlerësohet me mirënjohjen më të lartë nga OEMVP në 20-vjetorin e themelimit të saj

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) është nderuar me mirënjohjen më të lartë nga Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë së Veriut (OEMVP) në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të themelimit të kësaj organizate. Ky vlerësim i veçantë i është dhënë AKB-së për bashkëpunimin tradicional, të qëndrueshëm dhe të suksesshëm ndërmjet dy organizatave, që nga themelimi i OEMVP-së e deri

më sot. Me këtë rast, kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka falënderuar drejtuesit e OEMVP-së për këtë mirënjohje, duke theksuar se partneriteti ndërmjet organizatave ekonomike të rajonit është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit privat, rritjen e investimeve, avancimin e dialogut social dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve të rajonit. "Ky vlerësim është një nder për

AKB-në dhe një dëshmi e angazhimit tonë të përbashkët për fuqizimin e komunitetit të biznesit dhe zhvillimin ekonomik rajonal. Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë ura bashkëpunimi dhe partneriteti në interes të bizneseve dhe ekonomive tona", ka deklaruar Shahini, i cili në emër të AKB-së e ka uruar OEMVP-në për 20 vjet veprimtari të suksesshme dhe ka shprehur gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në të ardhmen.



# ZVËRNECI NUK ËSHTË I VETMI - NGA SHËN STEFANI TE DISNEY NË FRANCË, 10 RASTET KUR DEZINFORMIMI KA RREZIKUAR PROJEKTE TË MËDHA NË TURIZËM

Prej disa ditësh në Tiranë po zhvillohet një protestë kundër ndërtimit të një resorti ku do të investohen rreth 4 miliard USD në Zvërnec.

Protestuesit të cilët u nxitën nga një përplasje e banorëve me policinë në zonën që ishte rrethuar, kërkojnë anulimin e investimit, ndër të tjera edhe për shkak të ndikimit që do të ketë ai në ambient. Kundërshtarët e projektit argumentojnë se ekosistem në zonë mund të preket nga zhvillimi që po planifikohet. Në historinë e turizmit në botë, ky nuk është rasti i parë kur protesta lokale, dhe dezinformime me shifra të pakonfirmuara pengojnë investime të mëdha.

“Viktimë” e asaj që quhet Sindroma NIMBY “Not In My Backyard” (Jo në oborrin tim), kanë prekur edhe vende turistike me famë në Europë si Shën Stefani në Mal të Zi apo Disney në Francë.

Në sektorin e turizmit, NIMBY merr forma shumë specifike që mund të paralizojnë zhvillimin e një rajoni të tërë. Kur sindroma NIMBY ushqehet nga dezinformimi, pasojat janë të rënda si:

## Ngrirja e Kapitalit

Investitorët seriozë nuk kanë kohë të luftojnë pafundësisht në gjykata apo me protesta lokale. Ata e zhvendosin kapitalin e tyre në një shtet apo qytet tjetër më mikpritës.

## Stanacion i Komunitetit dhe ekonomisë

Zonat që mbyllen në vetvete nga frika, shpesh përfundojnë duke vuajtur nga papunësia, emigrimi i të rinjve dhe mungesa e infrastrukturës moderne, duke humbur mundësinë e zhvillimit pikërisht për shkak të refuzimit të tyre të hershëm.

Sindroma NIMBY nuk lindi si një fenomen për turizmin, por kalimi drejt projekteve turistike ndodhi rreth fundit të viteve '80 dhe fillimit të viteve '90. Gjithashtu u forcua më shumë në vitet 2000 kur bota njohu shpërthimin e “turizmit masiv”, të nxitur nga fluturimet e lira (loë-cost) dhe modelet e resorteve të mëdha.

Shkrimi më poshtë ofron një analizë të përmbledhur të 10 rasteve konkrete ku investime të markave globale (në turizëm,

infrastrukturë dhe teknologji) janë bllokuar ose anuluar si pasojë e drejtpërdrejtë e “Sindromës NIMBY” (Not In My Backyard) të fuqizuar me fushata dezinformimi.

## Aman Resorts dhe Bllokimi në Mal të Zi (Sveti Stefan)

Ky është një nga rastet më të famshme në Ballkan, ku politika, dezinformimi dhe populizmi lokal goditën një nga markat më të prestigjioze të hotelierisë në botë.

NIMBY/ Dezinformimi: AMAN kishte marrë me koncesion ishullin historik të Shën Stefanit. Në vitin 2021, me ndryshimin e qeverisë, debati politik, protestat lokale dhe narrativat publike kundër projektit u intensifikuan, u fillua gjithashtu një fushatë dezinformuese. Ata nxitën banorët duke pretenduar se Aman “po u vidhte detin Malazetëve” dhe se kontratat ishin të paligjshme. U shpërndanë lajme se vendasit nuk lejoheshin të ecnin as pranë plazheve.

Rezultati: Nën këtë presion grupe protestuesish prishën gardhet dhe hynë në plazhet e resortit. Aman Resorts, duke mos toleruar këtë dëmtim të imazhit dhe cenim të sigurisë, mbylli resortin për më shumë se një vit dhe e dërgoi shtetin e Malit të Zi në Arbitrazh Ndërkombëtar. Mali i Zi humbi përkohësisht simbolin e tij më të madh të turizmit elitare.

## Kur Grekët nuk kursenë as Grekët (e jo më Shqiptarët)

Rasti i Hotelit Luksoz “Moon Beach” (Milos, Greqi) Projekti: Ndërtimi i një kompleksi hotelierik ultra-luksoz me 5 yje në Sarakiniko, bregdeti ikonik vullkanik i njohur si “Plazhi i Hënës” në ishullin e Milosit, Greqi nisi një debat të gjerë. Projekti parashikonte një arkitekturë që do të shkrihej me shkëmbinj të bardhë, duke ofruar suita, vila dhe pishina private me pamje nga deti Egje. Qëllimi ishte transformimi i kësaj zone në një enklavë të turizmit elitare, e cila do të tërhiqte vizitorë me të ardhura shumë të larta në një nga peizazhet më të fotografuara të botës, duke rritur vlerën ekonomike të ishullit.



NIMBY/ Dezinformimi: Komuniteti lokal, i mbështetur fuqimisht nga OJQ-të mjedisore kombëtare, ndezi një fushatë të ashpër dhe agresive të tipit NIMBY. Edhe pse projekti synonte një klientelë të përzgjedhur, fushata u ngrit mbi frikën e “mbi-turizmit” (over-tourism) dhe mbrojtjes së ekosistemeve delikate. Argumenti mjedisor u përdor sërish si arma e vetme për të bllokuar investimin. Në publik u shpërndanë narrativa alarmante ku pretendohesh se: Plazhi ikonik do të kthehej në një “enklavë të mbyllur turistike”, duke u privatizuar dhe duke u ndaluar vendasve qasjen e lirë.

Peizazhi natyror “hënor”, i formuar prej miliona vitesh, do të shkatërrohej përgjithmonë nga ky “përbindësh betoni”. Ishulli i Milosit do të humbiste identitetin e tij cikladik nga makutëria e ndërtimeve të pakontrolluara. Kjo retorikë e polarizoi skajshmërisht debatin, duke e kthyer projektin në një tabelë qitjeje për aktivistët dhe duke e bërë të pamundur çdo dialog konstruktiv mes investitorëve dhe komunitetit.

Pasojat: Frika nga reagimi i publikut dhe mediatizimi i çështjes detyroi autoritetet politike të tërhiqeshin.

## Rasti i Mega-Resortit “Cape Sidero” (Sitia, Kretë, Greqi)

Projekti: Në gadishullin e mrekullueshëm të Cape Sidero, në rajonin e Sitias (Kretë), u propozua një nga investimet më madhështore të turizmit

elitar në Greqi. Projekti përfshinte ndërtimin e një mega-resorti ultra-luksoz të pajisur me hotele me pesë yje, fshatra turistike me vila ekskluzive dhe fusha golfi të standardeve botërore. Vizioni i investitorëve ishte ta kthenin këtë cep të fjetur të Kretës në një magnet për elitën globale, duke premtuar krijimin e mijëra vendeve të reja të punës, zhvillimin e infrastrukturës dhe një injeksion masiv kapitali që do të transformonte ekonominë e zonës.

NIMBY & Dezinformimi: Ashtu si në rastet e tjera të Mesdheut, shpallja e këtij mega-projekti ndezi menjëherë një reagim agresiv të tipit NIMBY nga aktivistët lokalë, kleri lokal (që zotëronte pjesë të tokave rrethuese) dhe OJQ-të mjedisore. Duke shfrytëzuar faktin që zona ishte relativisht e paprekur, fushata u ngrit mbi një propagandë frike për “urbanizimin masiv” të gadishullit.

Argumenti ekologjik u armatos sërish për të demonizuar zhvilluesit. Në komunitet u shpërndanë narrativa ekstreme ku pretendohesh se:

Fushat e golfit do të shteronin tërësisht burimet e pakta ujore të rajonit, duke e lënë bujqësinë lokale të thahej.

Peizazhi i virgjër natyror do të gëlltitej nga një “qytet i ri prej betoni”, duke shkatërruar habitatin dhe biodiversitetin. Identiteti tradicional i Sitias do të humbiste përgjithmonë nën kthetrat e korporatiave. Kjo qasje radikale dhe refuzuese krijoi një shqetësim publik që nuk la asnjë hapësirë për dialog, duke injoruar plotësisht

studimet e thelluara të inxhinierëve dhe premtimet e kompanisë për teknologji të gjelbra apo përdorimin e ujit të shkripëzuar për fushat e golfit. Pasojat: Beteja u shndërrua në një kalvar të pafundëm burokratik dhe ligjor. Procesi u mor peng nga paditë e njëpasnjëshme në Gjykatën e Lartë Administrative të Greqisë (Këshilli i Shtetit). Për vite me radhë, projekti mbeti plotësisht i ngrirë, duke e detyruar kompaninë zhvilluese të shpenzonte miliona në beteja ligjore dhe të rishikonte e zvogëlonte planin e saj vazhdimisht për t'u përshtatur me kërkesat e reja absurde. Rasti i Cape Sidero mbetet një nga shembujt më klasikë se si grupet e zhurmshme NIMBY, të fshihura pas petkut të mbrojtjes mjedisore, arrijnë të sabotojnë përmes bllokadave të pafundme ligjore zhvillimin ekonomik dhe investimet transformuese të turizmit të luksit.

## Disney dhe “Çernobili Kulturor” në Francë

Projekti: Ndërtimi i Disneyland Paris (fillimisht i quajtur Euro Disney) në vitet '90.

NIMBY/ Dezinformimi: Intelktualë, media lokale dhe fermerë francezë filluan një fushatë masive paniku. Ata e quajtën parkun një “Çernobil Kulturor”. Në komunitetet lokale u shpërndanë mesazhe sikur Disney do të shkatërronte fshatrat tradicionale francezë, do të sillte kulturë të rrugës amerikane, kriminalitet dhe do t'u bënte “shpëlarje truri” fëmijëve. Fermerët bllokuan

rrugët me traktorë. Rezultati: Ndonëse Disney ishte mjaftueshëm i fuqishëm financiarisht për ta shtyrë projektin përpara ky reagim fillestar e dëmtoi rëndë markën në vitet e para. Fushata e dezinformimit ishte aq e fortë sa që vitet e para parku ishte prag falimentimit për shkak të bojkotit lokal.

### Tërheqja e “Sandals Resorts” nga Tobago (2019)

Projekti: Projekti i planifikuar ishte i madh, një resort luksoz me rreth 750 dhoma, me investim të raportuar rreth 250 milionë USD.

NIMBY/ Dezinformimi: Projekti u përball me kundërshtime të forta politike, mjedisore dhe publike, duke gjeneruar një klimë të vazhdueshme publiciteti negativ.

Nga grupe të ndryshme u nxitën dezinformime se resorti do t'u "vidhte" plazhet vendasve, nuk do të paguante asnjë taksë dhe do të shkatërronte bizneset e vogla (krijuar panik për kolonizim turistik).

Rezultati: Në janar 2019, CEO i Sandals deklaroi se kjo atmosferë negative dhe debati i vazhdueshëm publik çuan kompaninë të tërhiqej nga projekti.

### Dështimi i “The London Resort” (Britani, 2022)

Projekti: Park tematik turistik prej 2.5 miliardë paundësh në Kent (i njohur si Disneylandi i Britanisë).

NIMBY/ Dezinformimi: Ndër të tjerat, grupet nxitën etiketimin e zonës industriale të braktisur

si habitatin jetik të një merimange të rrallë (jumping spider), duke amplifikuar lajmet se parku do të ishte një katastrofë ekologjike.

Rezultati: Investitorët u tërhoqën në vitin 2022 për shkak të kostove mjedisore dhe rezistencës lokale.

### Bllokimi i “MSG Sphere” në Londër (2023-2024)

Projekti: Ndërtimi i një kompleksi gjigante argëtimi në Stratford, Londër, investim miliarda dollarësh nga Madison Square Garden Entertainment. Projekti i propozuar nga Madison Square Garden Entertainment synonte ndërtimin e një strukture argëtimi “Sphere” në Stratford, Londër, u zhvillua si një investim i madh në sektorin e argëtimit urban.

NIMBY/ Dezinformimi: Fushata masive lokale e përqendruar te frika. Projekti u përball me kundërshtime gjatë procesit të planifikimit, ku banorët lokalë dhe autoritetet ngritën shqetësime për ndotjen vizuale nga ekranet LED, ndikimin në mjedisin urban dhe infrastrukturën e zonës.

U shpërndanë pretendime të ekzagjeruara se ndotja nga dritat do të shkaktonte sëmundje serioze dhe dritat LED do të verbonin shoferët e trenave dhe me një ndotje të madhe vizuale.

Rezultati: Kryebashkiaku i Londrës refuzoi projektin. MSG u tërhoq zyrtarisht në fillim të vitit 2024, duke e konsideruar mjedisin politik si “toksik”.

### Bllokimi i Kroçerave në Key West, Florida (SHBA)

Projekti: Porti turistik i Key Ëest

priste rregullisht anije gjigante kroçerash nga markat më të mëdha (Carnival, Royal Caribbean), të cilat sillnin mijëra turistë në ditë, duke qenë burimi kryesor i të ardhurave për ekonominë lokale.

NIMBY/Dezinformimi: Gjatë dhe pas pandemisë COVID-19, një komitet i vogël banorësh elitare dhe disa organizata nisën një fushatë agresive NIMBY. Ata ekzagjeruan të dhënat mjedisore dhe ekonomike, duke publikuar raporte të rreme në mediat sociale që pretendonin se pasagjerët e kroçerave “nuk shpenzonin” në qytet, se anijet po zhduknin koralet dhe se ishin vatra permanente të sëmundjeve infektive.

Rezultati:Të frikësuar dhe të manipuluar nga kjo fushatë, në vitin 2020 banorët e Key Ëest votuan në referendum për të kufizuar numrin e pasagjerëve në ditë ( në 1500). Kjo i kushtoi bizneseve të vogla turistike dhjetëra miliona dollarë humbje në muajt në vijim.

Debati u karakterizua nga argumente të forta pro dhe kundër industrisë së kroçerave, duke përfshirë shqetësime ekonomike për bizneset lokale dhe shqetësime mjedisore për ekosistemin detar. Pas referendumit, çështja u zhvendos në debate ligjore dhe shtetërore mbi kompetencat e qeverisjes lokale.

### Rasti i “Six Senses” në Parkun Kombëtar Tayrona (Kolumbi)

Projekti: Në vitin 2011, qeveria Kolumbiane (nën presidentin Juan Manuel Santos) shpalli projekt me markën ultra-luksoze aziatike Six Senses.

Qëllimi ishte të ndërtohej një eko-resort i nivelit të lartë në një pjesë të vogël të Parkut Kombëtar Tayrona, një xhungël e paprekur pranë detit të Karaibeve. Six Senses është globalisht e njohur pikërisht për ndërtimet pa beton, duke përdorur kasolle prej bambuje dhe druri të integruara thellë në pyll, për të ofruar “luks diskret” për klientët e pasur që e duan natyrën.

NIMBY / Dezinformimi: Njoftimi nxiti një reagim kombëtar dhe lokal. Ka informacione se kjo fushatë u nxit ndër të tjera edhe nga konkurentët e hoteleve rreth parkut dhe disa aktivistë radikalë u bashkuan për të përhapur dezinformim mbi planin e resortit. U përhap gënjeshtër se qeveria “po ia shiste xhunglën të huajve për t'u betonizuar” dhe se Six Senses do të priste qindra hektarë pemë për të hapur rrugë për “pishina gjigante betoni” dhe fusha golfi. Për t'i dhënë goditjen finale, në rrjetet sociale u shtuan teori se prania e turistëve të pasur do të shfaroste shpirtat e shenjtë të fiseve indigjene lokale (Kogi dhe Arhuaco).

Pasojat: Vala e indinjatës publike e bazuar në dezinformimin e “betonizimit” të xhunglës. Projekti u anulua përfshirë edhe vendimarrje gjyqësore dhe Six Sense u tërhoq. Kolumbia humbi mundësinë të kthehej në një destinacion të turizmit elitare mjedisor të nivelit botëror.

### Mega-Resortit “Cabo Cortés” (Baja California Sur, Meksikë)

Projekti : Cabo Cortés, i propozuar në fillim të viteve


2010 nga kompania spanjolle Hansa Urbana, ishte një mega-zhvillim turistik në Baja California Sur, Meksikë. Ai parashikonte ndërtimin e rreth 27,000 dhomave hoteli, fusha golfi dhe një marinë të madhe, me synimin për të krijuar një destinacion turistik masiv në bregdetin e Paqësorit.

NIMBY / Dezinformimi: Që në fazat e para, projekti u përball me një rezistencë të fortë NIMBY, ku komunitetet lokale, organizatat mjedisore dhe shkencëtarët kundërshtuan zhvillimin në shkallë të tillë. Kundërshtimi u fokusua kryesisht te:

ndikimi në shkëmbinjtë koralorë dhe ekosistemin detar, presioni mbi burimet e ujit në një zonë të thatë, rreziku i urbanizimit masiv në një zonë natyrore të ndjeshme. Ky mobilizim publik u bë një shembull tipik i konfliktit “zhvillim turistik masiv kundër ruajtjes së mjedisit” , ku interesat lokale dhe ekologjike u vendosën përballë investimeve të mëdha ndërkombehtarë. Gjatë diskutimit publik u shfaqën edhe narrativa të forta dhe shpesh të ekzagjeruara

Rezultati: Në vitin 2012, autoritetet mjedisore në Meksikë refuzuan lejet kryesore të projektit, duke e ndalur zhvillimin e tij. Rasti u bë një shembull i rëndësishëm i mënyrës se si NIMBY dhe presioni mjedisor mund të anulimin e mega-projekteve turistike.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Marseille, favorit për Zhegrovën

**TORINO, 3 QERSHOR** - Edon Zhegrova këtë verë pritet të largohet nga Juventusit dhe gjasat janë të mëdha që të rikthehet në Francë. Pas raportimeve se Juventusit ka nxjerrë në shitje sulmuesin e krahut, në skenë ka dalë

Marseille që po shihet favorit për transferimin e Zhegrovës. Juventusit po kërkon të paktën 12 milionë euro për kartonin e Zhegrovës si dhe është i hapur për mundësinë e huazimit të tij me opsionin e blerjes.

Kontaktet mes klubeve, mësohet se janë aktive dhe Marseille mund ta përshpejtojë transferimin e Zhegrovës, nëse brenda një periudhe të shkurtër e sheh anglezin Mason Greenwood. 27-vjeçari verën e shkuar iu

bashkua Juventusit nga Lille për 15 milionë, por te skuadra italiane nuk bindi me paraqitjet e tij. Ai ka kontratë deri në vitin 2030 me Juventusin, ekip për të cilin ka regjistruar 27 paraqitje në total, në të gjitha garat.



## 'DARDANËT' VAZHDOJNË PËRGATITJET PËR ANDORRËN

**PRISHTINË, 3 QERSHOR** - Futbollistët e Kombëtares së Kosovës të mërkurën kanë zhvilluar stërvitjen e radhës në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen miqësore kundër Andorrës. Përballja ndërmjet Kosovës dhe Andorrës do të zhvillohet të dielën nga ora 20:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Edhe në këtë seancë stërvitore

është punuar me përkushtim, disiplinë të lartë dhe ritëm të mirë, ku selektori Franco Foda po bën gati ekipin për këtë miqësore. Duhet theksuar se atmosfera në kampin e "Dardanëve" mbetet shumë pozitive, një sinjal ky i rëndësishëm se të gjithë futbollistët janë gati të luajnë në stadiumin e kryeqytetit. Kjo është konfirmuar edhe nga

mbrojtësi Ron Raqi, i cili ka thënë se tashmë kanë lënë prapa humbjen nga Çekia dhe po mendojnë për ndeshjen kundër Andorrës. Megjithatë, gjatë stërvitjes së sotme, portieri Arijanet Muriq ka ndier një shqetësim muskolor dhe se do t'u nënshtrohet ekzaminimeve të hollësishme për të parë nëse bëhet fjalë për ndonjë lëndim



serioz. "Gjatë stërvitjes, portieri Arijanet Muriq ka ndier shqetësim në muskujt e

kërdhokullës së djathtë. Staf i mjekësor i kombëtares do t'i kryejë ekzaminimet e nevojshme për të konstatuar nëse bëhet fjalë për ndonjë lëndim që mund ta lë jashtë fushës", ka njoftuar FFK-ja. "Dardanët" do të vazhdojnë me përgatitje, ku stërvitjen e radhës do ta mbajnë sot (e enjte), gjithashtu në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet.

## FILLON TRAJNIMI NË KUADËR TË PROJEKTIT 'FIFA TALENT DEVELOPMENT SCHEME (TDS)'

**PRISHTINË, 3 QERSHOR** - Federata e Futbollit e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me FIFA-n, ka nisur punëtorinë treditore të projektit "FIFA Talent Development Scheme (TDS)", e cila po zhvillohet në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Në këtë aktivitet po marrin pjesë trajnerët e programit "FFK Talent Coach Academy", përfaqësuesit e projektit "Elite Youth Development", edukatorët e



FFK-së si dhe trajnerët e ekipeve kombëtare të grupmoshave. Qëllimi kryesor i këtij trajnimit është avancimi i njohurive dhe

praktikave për identifikimin, edukimin dhe zhvillimin e talenteve të reja në futbollin e Kosovës. Punëtorja po udhëhiqet nga ekspertët e FIFA-s Mirelle van Rijbroek, Zeb Jacobs, Bo Jacobs, Andy Gould dhe Arnar Vidarsson, mentor i FIFA-s për Kosovën, të cilët do t'i paraqesin praktikën me të mira të futbollit elitare dhe përvojat ndërkombëtare. Temat kryesore të trajnimit janë:

Identifikimi dhe zhvillimi individual i talenteve; Skautimi dhe analiza e performancës; Përdorimi i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në edukimin e trajnerëve; Metodologjitë moderne për zhvillimin e futbollistëve; derisa ky program përfshin edhe vëzhgimet praktike, analiza ndeshjesh dhe diskutime profesionale. Ky aktivitet shënon një hap të

rëndësishëm në zbatimin e projektit TDS në Kosovë, duke konfirmuar përkushtimin e FFK-së dhe FIFA-s për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe afatgjatë për identifikimin dhe zhvillimin e talenteve. Përmes këtij programi, futbollit i Kosovës po vendos themelet për një të ardhme më profesionale, më konkurruese dhe më të integruar në standardet ndërkombëtare.

## NJË BILETË PËR FINALEN E KUPËS SË BOTËS KUSHTON DERI NË 11.5 MILIONË DOLLARË, FIFA NËN KRITIKA TË MËDHA

**ZURICH, 3 QERSHOR** - Federata Ndërkombëtare e Futbollit (FIFA) po përballet me kritika të ashpra nga publiku pasi paraqiti një model dinamik çmimesh në platformën e saj të rishitjes, të modeluar sipas linjave ajrore, shkruan "Time". Ky sistem i diskutueshëm ka bërë që çmimi i kërkuar për një biletë të vetme për finalen e Kupës së Botës ta arrijë shifrën marramendëse prej 11.5 milionë dollarësh.

Ndërsa drejtuesit e FIFA-s e justifikojnë këtë veprim si një përpjekje për t'u përballur me tregun e fortë sekondar në ShBA, shoqatat e tifozëve dhe profesioni ekonomik e quajnë strategjinë "lakmi" dhe një "tradhti monumentale". Ekspertët paralajmërojnë se korporatizimi agresiv i hapësirave sportive rrezikon t'i eliminojë plotësisht mbështetësit më të apasionuar dhe t'i kthejë stadiumet në

vende të qeta grumbullimi të rezervuara ekskluzivisht për mysafirët VIP. Megjithatë, kjo qasje elitiste po tregon tashmë shenja serioze dështimi, pasi një numër i madh biletash mbeten të pashitura. Çmimet shumë të larta të biletave i dekurajojnë drejtpërdrejt turistët të udhëtojnë, gjë që konfirmohet nga të dhënat e Shoqatës Amerikane të Hoteleve dhe Strehimeve, e cila regjistron një

numër dukshëm më të ulët rezervimesh sesa pritej. Amerika heq kufizimin e depozitës prej 15 mijë eurove për tifozët në Botëror, por dy vende ende kanë ndalesë. Deri në 80 për qind e të anketuarve në qytetet pritëse amerikane deklaruan se niveli i mbushjes së vendeve ishte nën të gjitha vlerësimet fillestare. Pavarësisht prej tronditjes financiare, ekspertët thonë se për tifozët e vërtetë të futbollit



ka ende mënyra dhe truke për të anashkaluar këto kosto astronomike dhe për ta ndjekur kampionatin e ardhshëm.



## Lazio nis kontaktet për Brojën

**ROMË, 3 MAJ** - Sulmuesi i Shqipërisë, Armando Broja, po del gjithnjë e më shumë si një opsion real te skuadra e Lazios për sezonin e ri. Pas raportimit se Lazio ka shprehur interesim për Brojën, bëhet me dije se

ekipi italian tashmë ka nisur lëvizjet për t'i siguruar shërbimet e tij. Mësohet se Lazio ka kontaktuar Burnleyn, ekip që për kartonin e Brojës po kërkon të paktën 12 milionë euro, pasi 23-vjeçari ka

kërkuar largimin. Te Lazio janë të gatshëm për ta huazuar Brojën përgjatë sezonit 2026/27 dhe verën tjetër ta kenë opsionin për të drejtën e blerjes së tij. Marrëveshja mes klubeve

mund të arrihet së shpejti, pasi edhe Broja është i gatshëm për ta vazhduar karrierën në Serinë A të Italisë. Ai vitin e shkuar iu bashkua Burnleyt dhe ka kontratë deri në verën e vitit 2030.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës  
01-Nr. 016-25125  
Me datë: 02.06.2026

Ne bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Ligji Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009), me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 10 dhjetor 2010; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016); bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për shqyrtimin e mëtej të kërkesës së subjektit kërkuar të Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari; bazuar në Vendimin Preliminar mbi ligjëshmerinë e shpronësimit të paluajtshmerisë me nr. prot. 01-Nr-464-10615 datë 04.03.2026, për "ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë", Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë:

### VENDIM PËRFUNDIMTAR

**I. SHPRONSOHET** prona private e pronarëve dhe zotruarëve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-3, në sip. prej 188m<sup>2</sup> me kultur Arë e Klasës 2, në vendin e quajtur "RUPE/DRUM" e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Qazim Ibrahim Jasharaj 1/2; Fatmir Munish Jasharaj 1/16; Gazmend Munish Jasharaj 1/16; Shpend Munish Jasharaj 1/16; Elfiye Hysen Jasharaj 1/16 dhe Durmish Ramadan Jasharaj 1/4 ZK. Sopijë.

**II. VERTETOHET** se ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës publike në Zonën Kadastrale Sopijë, është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe se shpronësimi i paluajtshmerisë së lartëcekur do të shërbejë për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

**III.** Pjesë integrale e këtij vendimi është raporti i vlerësimit i pranuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme /Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Pronarët e paluajtshmerisë për pronën e shpronësuar të evidentuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, kompenzohen konform Aktit-vlerësimit të pranuar si në tabelën e bashkangjitur në shumën prej: 25.00€/m<sup>2</sup> (njëzet e pesë euro.€), ndërsa për pronën e përgjithshme të shpronësuar në sip. prej: 188m<sup>2</sup>, kompenzohet në shumën totale prej: 4.700.00 €. ( katëremij e shtatqind euro.€).

**IV** Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar, Organi shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen në Vendimin Përfundimtar.

**V.** Në përputhje me nenin 11 paragrafi 8, nenin 12 dhe nenin 16 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Ligji Nr. 03/L-139, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Përfundimtar, dhe pas pagesës së kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim, si dhe pas plotësimit të kushteve të parapara me ligj, Drejtoria Për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës merr të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në emër të PSH Komuna e Suharekës.

**VI.** Vendimi Përfundimtar hynë në fuqi datën e shpalljes në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

### Arsyetim

Subjekti kërkuar-Drejtoria për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari në Komunën e Suharekës, me kërkesën nr. 01-052-69255 të datës 05.11.2025 ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës iniciimin e procedurës administrative për shpronësimin e paluajtshmerisë për interes publik dhe për realizimin e projektit për "ndërtimi i rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë", si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Subjekti kërkuar, kësaj kërkesë ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm i cili parashihet me dispozitat e nenit 8, lidhur me nenin 4, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës ka ardh në përfundim se shpronësimi i paluajtshmerisë të evidentuar në dispozitiv të këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtij qëllim, dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës së paluajtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organi shpronësues- Kryetari i Komunës ka miraturar kërkesën e subjektit kërkuar për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim me nr. Prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025

Po ashtu në afatin ligjorë, organi shpronësues ka miraturar Vendimin Preliminar për ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar me nr. prot. 01-Nr-464-10615 datë 04.03.2026

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkuar për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzime Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej 30 ditëve kalendarike pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Vendimi. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzojë në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për Shpronësim).

Vendimi u dërgohet:  
Subjektit kërkuar  
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe  
Arkivit

Kryetari i Komunës  
Bali Muharremaj  
për:



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës  
01-Nr. 016-25130  
Me datë: 02.06.2026

Ne bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Ligji Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009), me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 10 dhjetor 2010; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016); bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për shqyrtimin e mëtej të kërkesës së subjektit kërkuar të Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari; bazuar në Vendimin Preliminar mbi ligjëshmerinë e shpronësimit të paluajtshmerisë me nr. prot. 01-Nr-464-10619 datë 04.03.2026, për "ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë", Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë:

### VENDIM PËRFUNDIMTAR

**I. SHPRONSOHET** prona private e pronarëve dhe zotruarëve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-3, në sip. prej 12m<sup>2</sup> me kultur Arë e Klasës 2, në vendin e quajtur "RUPE/DRUM" e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Valon (Xhelal) Kuçi ZK. Sopijë.

**II. VERTETOHET** se ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës publike në Zonën Kadastrale Sopijë, është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe se shpronësimi i paluajtshmerisë së lartëcekur do të shërbejë për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

**III.** Pjesë integrale e këtij vendimi është raporti i vlerësimit i pranuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme /Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Pronarët e paluajtshmerisë për pronën e shpronësuar të evidentuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, kompenzohen konform Aktit-vlerësimit të pranuar si në tabelën e bashkangjitur në shumën prej: 20.00€/m<sup>2</sup> (njëzet euro.€), ndërsa për pronën e përgjithshme të shpronësuar në sip. prej: 12m<sup>2</sup>, kompenzohet në shumën totale prej: 240.00 €. ( dyqind e katërdhjet euro €).

**IV** Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar, Organi shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen në Vendimin Përfundimtar.

**V.** Në përputhje me nenin 11 paragrafi 8, nenin 12 dhe nenin 16 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Ligji Nr. 03/L-139, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Përfundimtar, dhe pas pagesës së kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim, si dhe pas plotësimit të kushteve të parapara me ligj, Drejtoria Për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës merr të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në emër të PSH Komuna e Suharekës.

**VI.** Vendimi Përfundimtar hynë në fuqi datën e shpalljes në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

### Arsyetim

Subjekti kërkuar-Drejtoria për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari në Komunën e Suharekës, me kërkesën nr. 01-052-69255 të datës 05.11.2025 ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës iniciimin e procedurës administrative për shpronësimin e paluajtshmerisë për interes publik dhe për realizimin e projektit për "ndërtimi i rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë", si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Subjekti kërkuar, kësaj kërkesë ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm i cili parashihet me dispozitat e nenit 8, lidhur me nenin 4, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës ka ardh në përfundim se shpronësimi i paluajtshmerisë të evidentuar në dispozitiv të këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtij qëllim, dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës së paluajtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organi shpronësues- Kryetari i Komunës ka miraturar kërkesën e subjektit kërkuar për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim me nr. Prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025

Po ashtu në afatin ligjorë, organi shpronësues ka miraturar Vendimin Preliminar për ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar me nr. prot. 01-Nr-464-10619 datë 04.03.2026

**Bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për shqyrtimin e mëtej të kërkesës së subjektit kërkuar të Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari; bazuar në Vendimin Preliminar mbi ligjëshmerinë e shpronësimit të paluajtshmerisë me nr. prot. 01-Nr-464-10619 datë 04.03.2026, parcela kadastrale P-72116043-01098-3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 272m<sup>2</sup> ka figuruar në emër të Isuf (Adem) Kryeziu. Nga gjendja juridike e tanishme shihet se ka ndryshim pronari, sipas kontratës për Blerje Nr. ref.: 381/2026 Nr. rend. LRP: 1482/2026, dhe azhurnimit në kadastër me datën 04.05.2026. Tani parcela kadastrale figuron në emër të Valon (Xhelal) Kuçi.**

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkuar për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

